



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.106**

**7 gusht**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 451 datë 21.7.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare”.....	4215
Ligj nr.10 452 datë 21.7.2011	Për ratifikimin e protokollit që ndryshon aneksin e sigurisë të marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, për bashkëpunimin për informacionin atomik.....	4231
Ligj nr.10 453 datë 21.7.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar dhe protokollit të saj të zbatimit”.....	4232
Vendim i KM nr.527, datë 20.7.2011	Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi.....	4247

**LIGJ**  
**Nr.10 451, datë 21.7.2011**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN “PËR ZGJIDHJEN  
PAQËSORE TË MOSMARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën “Për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7065, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**KONVENTA**  
**PËR ZGJIDHJEN PAQËSORE TË MOSMARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE, E VITIT**  
**1907**

Madhëria e Tij Perandori gjerman, Mbreti i Prusisë, Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Presidenti i Republikës së Argjentinës, Madhëria e Tij Perandori i Austrisë, Mbret i Bohemisë etj., dhe Mbreti Apostolik i Hungarisë, Madhëria e Tij Mbreti i Belgjikës, Presidenti i Republikës së Bolivisë, Presidenti i Republikës së Shteteve të Bashkuara të Brazilit; Madhëria e Tij Mbretërore Princi i Bullgarisë, Presidenti i Republikës së Kilit, Madhëria e Tij Perandori i Kinës, Presidenti i Republikës së Kolumbisë, Guvernatori i Përkohshëm i Republikës së Kubës, Madhëria e Tij Mbreti i Danimarkës, Presidenti i Republikës Dominikane, Presidenti i Republikës së Ekuadorit, Madhëria e Tij Mbreti i Spanjës, Presidenti i Republikës së Francës; Madhëria e Tij Mbreti i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës dhe e Zotërimeve Britanike përtej detit, Perandori i Indisë, Madhëria e Tij Mbreti Helen, Presidenti i Republikës së Guatemalës, Presidenti i Republikës së Haitit; Madhëria e Tij Mbreti i Italisë, Madhëria e Tij Perandori i Japonisë; Madhëria e Tij Mbretërore Duka i Madh i Luksemburgut, Duka i Nasaut, Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Meksikës, Lartësia e Tij Mbretërore Princi i Malit të Zi, Presidenti i Republikës së Nikaraguas, Madhëria e Tij Mbreti i Norvegjisë, Presidenti i Republikës së Panamasë, Presidenti i Republikës së Paraguait, Madhëria e Saj Mbretëresha e Holandës, Presidenti i Republikës së Perusë, Madhëria e Tij Supreme Shahu i Persisë; Madhëria e Tij Mbreti i Rumanisë, Madhëria e Tij perandori i të gjithë Rusisë; Presidenti i Republikës së Salvadorit, Madhëria e Tij Mbreti i Serbisë, Madhëria e Tij Mbreti i Siamit, Madhëria e Tij Mbreti i Suedisë, Këshillit Federal Zvicëran, Madhëria e Tij Perandori i Osmanëve, Presidenti i Republikës Orientale të Uruguait, Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Venezuelës;

*të nxitur* nga dëshira e sinqertë për të punuar për ruajtjen e paqes së përgjithshme;  
*të vendosur* për të përkrahur me të gjitha përpjekjet e pushtetit të tyre zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare;

*duke njohur* solidaritetin që bashkon anëtarët e shoqërisë së kombeve të qytetëruara;  
*me dëshirën* për zgjerimin e perandorisë së ligjit dhe për forcimin e vlerësimit të drejtësisë ndërkombëtare;

*të bindur* se institucioni i përhershëm i një gjykate arbitrazhi i arritshëm për të gjithë, mes fuqive të pavarura, do të kontribuojë në mënyrë efektive për këtë qëllim;

*duke pasur* parasysh avantazhet që sjell pjesëmarrja në organizimin e përgjithshëm dhe të rregullt të procedurës së arbitrazhit;

*duke ndarë* të njëjtin mendim me nismëtarin e Konferencës Ndërkombëtare të Paqes së mbajtur në gusht, se dokumentimi në një marrëveshje ndërkombëtare i parimeve të barazisë dhe të drejtës mbi të cilat janë të bazuara siguria e shteteve dhe mirëqenia e popujve, është i përshtatshëm;

*me këtë synim*, duke dëshiruar garantimin e funksionimit më të mirë në praktikë të komisioneve të hetimeve dhe gjykatave të arbitrazhit, dhe lehtësimin e adresimit të gjyqit në rastet të cilat lejojnë një procedurë të shkurtuar;

*e kanë konsideruar* të nevojshme të rishikojnë disa raporte të hollësishme dhe të përfundojnë punën e Konferencës së Parë të Paqes për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare;

Palët e larta kontraktuese kanë vendosur të përfundojnë një Konventë të re për këtë qëllim, dhe kanë emëruar të Plotfuqishmit e tyre, si më poshtë:

(Lista e të Plotfuqishmëve)

Të cilët, pasi kanë depozituar kompetencat e tyre të plota, në formën e duhur dhe të përshtatshme, kanë rënë dakord si më poshtë:

## PJESA I RUAJTJA E PAQES SË PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me synimin për të shmangur sa më shumë përdorimin e forcës në marrëdhëniet midis shteteve, palët kontraktuese bien dakord për të përdorur përpjekjet e tyre më të mira për të siguruar zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

## PJESA II PALËT E TRETA DHE NDËRMJETËSIMI

### Neni 2

Në rast mosmarrëveshjeje serioze ose konflikti, para se t'i drejtohen gjykatës, shtetet kontraktuese bien dakord që kanë të drejtë, aq sa e lejojnë rrethanat, t'i drejtohen palëve të treta ose ndërmjetësimit të një ose më shumë shteteve mike.

### Neni 3

Pavarësisht nga kjo e drejtë, shtetet kontraktuese konsiderojnë të nevojshme dhe të përshtatshme që një ose më shumë shtete, jo palë në konflikt, duhet, me iniciativën e tyre dhe aq sa e lejojnë rrethanat, të ofrojnë ndihmën e tyre apo ndërmjetësimin për shtetet që janë në mosmarrëveshje.

Shtetet që nuk janë pjesë e konfliktit kanë të drejtë të ofrojnë ndihmën e tyre apo të ndërmjetësojnë edhe gjatë gjendjes së luftës.

Ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund të konsiderohet nga asnjëra prej palëve në mosmarrëveshje, si një akt armiqësor.

#### Neni 4

Roli i ndërmjetësuesit konsiston në zgjidhjen e pretendimeve të kundërta dhe në zbutjen e pakënaqësive që mund të kenë lindur mes shteteve që kanë mosmarrëveshje.

#### Neni 5

Funksionet e ndërmjetësuesit përfundojnë kur nga një prej palëve në mosmarrëveshje apo nga vetë ndërmjetësi, deklarohet që mjetet e pajtimit të propozuara nga ai nuk janë pranuar.

#### Neni 6

Ndërhyrja e palëve të treta dhe ndërmjetësimi, të ndërmarra me kërkesë të palëve në mosmarrëveshje, ose me iniciativën e shteteve që nuk kanë lidhje me mosmarrëveshjen, ka vetëm karakter këshillimor dhe asnjëherë nuk ka fuqi detyruese.

#### Neni 7

Pranimi i ndërmjetësimit nuk mund të ketë ndikim për të ndërprerë, vonuar apo penguar mobilizimin apo masat e tjera të përgatitjes për luftë, përveç rasteve kur ka një marrëveshje për të kundërtën.

Nëse kjo ndodh pas fillimit të luftimeve, operacionet ushtarake që po kryhen, nuk ndërpriten veçse kur ka një marrëveshje të kundërt.

#### Neni 8

Shtetet kontraktuese bien dakord, kur e lejojnë rrethanat, që të rekomandojnë zbatimin e ndërmjetësimit të veçantë në formën e mëposhtme:

Në rast të një mosmarrëveshjeje serioze që rrezikon paqen, shtetet në konflikt zgjedhin përkatësisht një shtet të cilit i besojnë misionin e hyrjes në një komunikim të drejtpërdrejtë me shtetin e zgjedhur në anën tjetër, me qëllim parandalimin e prishjes së marrëdhënieve paqësore.

Për periudhën e këtij mandati, afati i të cilit, me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe, nuk mund të tejkalojë tridhjetë ditë, shtetet në konflikt pushojnë çdo lloj komunikimi të drejtpërdrejtë në lidhje me çështjen në konflikt, e cila konsiderohet se i përket vetëm shteteve ndërmjetësuese, të cilët duhet të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zgjidhur atë.

Në rast të prishjes përfundimtare të marrëdhënieve paqësore, këto shtete ngarkohen me detyrën e përbashkët që të shfrytëzojnë çdo mundësi për të rivendosur paqen.

### PJESA III KOMISIONET NDËRKOMBËTARE HETIMORE

#### Neni 9

Në konfliktet e natyrës ndërkombëtare, që nuk përfshijnë as nderin as interesat jetësorë, dhe që rrjedhin nga një ndryshim mendimi në çështjet e fakteve, shtetet kontraktuese konsiderojnë të nevojshme dhe të përshtatshme që palët të cilat nuk kanë qenë në gjendje për të arritur një marrëveshje me anë të diplomacisë, duhet, aq sa e lejojnë rrethanat, të krijojnë një Komision Hetimor Ndërkombëtar për të lehtësuar një zgjidhje të këtyre konflikteve, duke shqyrtuar faktet nëpërmjet një hetimi të paanshëm dhe të drejtë.

## Neni 10

Komisionet hetimore ndërkombëtare krijohen me marrëveshje të veçantë midis palëve në konflikt.

Konventa mbi hetimin përcakton faktet që do të shqyrtohen, përcakton mënyrën dhe kohën në të cilën do të ngrihet Komisioni dhe shtrirjen e kompetencave të Komisionerëve.

Ajo gjithashtu përcakton, nëse ka nevojë, vendin ku do të mbliidhet Komisioni, dhe nëse mund të zhvendoset në një vend tjetër, gjuhën që Komisioni do të përdorë dhe gjuhët, përdorimi i të cilave do të autorizohen para tij, si dhe datën në të cilën secila palë duhet të depozitohet deklarata e vet të fakteve, dhe, në përgjithësi, të gjitha kushtet mbi të cilat palët kanë rënë dakord.

Nëse palët e konsiderojnë të nevojshme emërimin e ekspertëve, Konventa mbi hetimin do të përcaktojë mënyrën e përzgjedhjes së tyre, si dhe shtrirjen e kompetencave të tyre.

## Neni 11

Nëse Konventa mbi hetimin nuk përcakton vendin ku do të mbliidhet Komisioni, ai do të mbliidhet në Hagë.

Kur përcaktohet vendi i takimit, ai nuk mund të ndryshohet nga Komisioni përveçse me pëlqimin e palëve.

Nëse Konventa mbi hetimin nuk ka përcaktuar se cilat gjuhë do të përdoren, çështja do të zgjidhet nga Komisioni.

## Neni 12

Komisionet hetimore do të formohen në mënyrën e përcaktuar nga nenet 45 dhe 57 të kësaj Konvente, me përjashtim të rasteve kur është bërë një marrëveshje për të kundërtën.

## Neni 13

Nëse njëri nga komisionerët ose ekspertët, nëse ka të tillë, vdes, jep dorëheqjen, ose është i paafët për çfarëdo arsye për të kryer funksionet e tij, për zëvendësimin e tij ndiqet procedura e njëjtë si për emërimin.

## Neni 14

Palët kanë të drejtë të caktojnë agjentë të posaçëm për të marrë pjesë në Komisionin Hetimor, detyra e të cilëve është t'i përfaqësojnë ata dhe të veprojnë si ndërmjetës midis tyre dhe Komisionit.

Për më tepër, ata janë të autorizuar që të angazhojnë avokatë ose mbrojtës, të caktuar prej tyre, për të paraqitur çështjen e tyre dhe për të mbrojtur interesat tyre para Komisionit.

## Neni 15

Zyra Ndërkombëtare e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit shërben si zyrë regjistri për komisionet, të cilat mbliidhen në Hagë, dhe do të vendosin zyrat dhe personelin e tyre në dispozicion të shteteve kontraktuese për t'u përdorur nga Komisioni Hetimor.

## Neni 16

Nëse Komisioni mbliidhet diku tjetër dhe jo në Hagë, ai cakton Sekretarin e Përgjithshëm, zyra e të cilit shërben si zyrë regjistri.

Është detyra e zyrës së regjistrit, nën kontrollin e Kryetarit, që të bëjë rregullimet e nevojshme për seancat e Komisionit, përgatitjen e procesverbaleve, dhe, ndërsa hetimi vazhdon, grumbullohen në arkiva, që më pas do të transferohen në Zyrën Ndërkombëtare në Hagë.

#### Neni 17

Me qëllim lehtësimin e ngritjes dhe punës së komisioneve hetimore, shtetet kontraktuese rekomandojnë rregullat e mëposhtme, të cilat do të jenë të zbatueshme për procedurën e hetimit, për sa kohë që palët nuk miratojnë rregulla të tjera.

#### Neni 18

Komisioni do të përcaktojë detajet e procedurës, të cilat nuk parashikohen nga Konventa për hetimin e posaçëm ose nga kjo Konventë, dhe do të caktojë të gjitha formalitetet e nevojshme për trajtimin e provave.

#### Neni 19

Në hetim duhet të dëgjohen të dyja palët.

Në datat e përcaktuara, çdo palë i dërgon Komisionit dhe palës tjetër deklaratat e fakteve, nëse ka, dhe në të gjitha rastet, dokumentet ligjore, shkresat, dhe dokumentet të cilat ajo i konsideron të dobishme për përcaktimin e së vërtetës, si dhe listën e dëshmitarëve dhe ekspertëve, dëshmia e të cilëve dëshiron që të dëgjohet.

#### Neni 20

Komisioni ka të drejtë, me miratimin e shteteve, të lëvizë përkohësisht në çdo vend ku ai e konsideron se mund të jetë e dobishme për të përdorur këtë mjet të hetimit apo për të dërguar një ose më shumë anëtarë të tij. Leja duhet të merret nga shteti, në territorin e të cilit është propozuar kryerja e hetimit.

#### Neni 21

Çdo hetim dhe çdo ekzaminim i një vendi duhet të bëhet në praninë e agjentëve dhe mbrojtësve të palëve ose pasi ata të jenë thirrur për të marrë pjesë sipas rregullave.

#### Neni 22

Komisioni ka të drejtë të kërkojë nga secila palë shpjegime dhe informacion të cilat ai i konsideron të nevojshme.

#### Neni 23

Palët marrin përsipër të ofrojnë për Komisionin Hetimor, në mënyrën më të plotë të mundshme, të gjitha mjetet dhe shërbimet e nevojshme për të bërë të mundur që ai të njihet plotësisht dhe të kuptojë saktësisht faktet në fjalë.

Ato marrin përsipër të përdorin mjetet në dispozicion të tyre, sipas ligjit të tyre të brendshëm, për të garantuar paraqitjen e dëshmitarëve apo ekspertëve, të cilët gjenden në territorin e tyre dhe janë thirrur para Komisionit.

Nëse dëshmitarët ose ekspertët nuk janë në gjendje të paraqiten para Komisionit, palët do të caktojnë që dëshmia e tyre të merret nga zyrtarë të kualifikuar të vendit të tyre.

#### Neni 24

Për të gjitha njoftimet që dërgohen nga Komisioni në territorin e një shteti të tretë kontraktues, Komisioni do t'i drejtohet drejtpërdrejt qeverisë së shtetit të lartpërmendur. I njëjti rregull vlen edhe në rastin e hapave që ndërmerren në vend, për të siguruar prova.

Kërkesat për këtë qëllim do të ekzekutohen, aq sa e lejojnë mjetet në dispozicion të shtetit të kërkuara sipas legjislacionit të tij të brendshëm. Ato nuk mund të refuzohen, me përjashtim të rasteve kur shteti në fjalë mendon se ato janë kryer për të cenuar të drejtat sovrane ose sigurinë e tij.

Komisioni, në të njëjtën mënyrë, do të ketë gjithmonë të drejtë për të vepruar nëpërmjet shtetit, në territorin e të cilit ai qëndron.

#### Neni 25

Dëshmitarët dhe ekspertët thirren me kërkesë të palëve ose nga Komisioni me iniciativën e tij, dhe, në çdo rast, nëpërmjet qeverisë së shtetit në territorin e të cilit ata janë.

Dëshmitarët dëgjohen me radhë dhe veçmas, në praninë e agjentëve dhe avokatëve dhe në rendin e përcaktuar nga Komisioni.

#### Neni 26

Marrja në pyetje e dëshmitarëve drejtohet nga kryetari.

Megjithatë, anëtarët e Komisionit mund t'i bëjnë pyetje çdo dëshmitari, të cilat ata mendojnë që mund të hedhin dritë dhe plotësojnë dëshminë e tij, apo të marrin informacion në çdo moment në lidhje me dëshmitarin, brenda kufijve të asaj që është e domosdoshme me qëllim gjetjen e së vërtetës.

Agjentët dhe avokatët e palëve mund të mos ndërpresin dëshmitarin kur ai është duke bërë deklaratën e tij, as ta pyesin atë drejtpërdrejt, por ata mund t'i kërkojnë kryetarit të bëjë pyetje shtesë të tilla që ata mendojnë se janë të përshtatshme për t'u bërë.

#### Neni 27

Dëshmitari duhet të japë dëshminë e tij pa u lejuar të lexojë ndonjë draft me shkrim. Megjithatë, ai mund të lejohet nga kryetari që të konsultohet me shënime ose dokumente, nëse natyra e fakteve të referuara kërkon përdorimin e tyre.

#### Neni 28

Një procesverbal i dëshmisë së dëshmitarit hartohet menjëherë dhe i lexohet atij. Dëshmitari mund të bëjë ndryshime dhe shtesa të nevojshme, të cilat do të regjistrohen në fund të deklaratës së tij.

Pasi i është lexuar e gjithë dëshmia, dëshmitarit i kërkohet ta nënshkruajë atë.

#### Neni 29

Agjentët autorizohen, gjatë ose në përfundim të hetimeve, të paraqesin me shkrim para Komisionit dhe palës tjetër deklarata, kërkesa me shkrim ose përmbledhje të fakteve, të cilat i konsiderojnë të dobishme për përcaktimin e së vërtetës.

#### Neni 30

Komisioni i shqyrton vendimet e tij në fshehtësi dhe seancat janë të fshehta.

Të gjitha vendimet merren me shumicën e anëtarëve të Komisionit.

Nëse një anëtar refuzon të votojë, ky fakt duhet të regjistrohet në procesverbal.

#### Neni 31

Seancat e Komisionit nuk janë publike, as procesverbalet dhe dokumentet e lidhura me hetimin nuk botohen, me përjashtim të rasteve kur me pëlqimin e palëve është marrë vendim nga Komisioni.

#### Neni 32

Pasi palët të kenë paraqitur të gjitha shpjegimet dhe provat, dhe të gjithë dëshmitarët të kenë dhënë dëshminë e tyre, kryetari deklaron përfundimin e hetimit dhe Komisioni tërhiqet për të diskutuar dhe përpiluar raportin e tij.

#### Neni 33

Raporti nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.  
Nëse një prej anëtarëve nuk pranon të nënshkruajë, ky fakt përmendet, por nuk cenohet vlefshmëria e raportit.

#### Neni 34

Raporti i Komisionit lexohet në një seancë publike, agjentët dhe avokatët e palëve janë të pranishëm apo thirren sipas rregullit.  
Një kopje e raportit i jepet secilës palë.

#### Neni 35

Raporti i Komisionit nuk përmban deklaratë të fakteve, dhe në asnjë mënyrë nuk ka karakterin e një vendimi. Ai i lë palëve lirinë e plotë për sa i përket rezultatit që do të ketë deklarata.

#### Neni 36

Secila palë paguan shpenzimet e saj dhe një pjesë e barabartë e shpenzimeve paguhet nga Komisioni.

### PJESA IV ARBITRAZHI NDËRKOMBËTAR

#### KAPITULLI I SISTEMI I ARBITRAZHIT

#### Neni 37

Arbitrazhi ndërkombëtar ka si objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve nga gjyqtarët të cilët i zgjedhin vetë mbi bazën e respektimit të ligjit.  
T'i drejtohesh arbitrazhit nënkupton një angazhim për të pranuar në mirëbesim vendimin e tij.

#### Neni 38

Në çështje të natyrës ligjore dhe veçanërisht në interpretimin ose zbatimin e konventave ndërkombëtare, arbitrazhi njihet nga shtetet kontraktuese si më efektiv dhe në të njëjtën kohë, mjeti më i drejtë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që diplomacia ka dështuar t'i zgjidhë.

Rrjedhimisht, do të ishte e përshtatshme që në konfliktet në lidhje me çështjet e mësipërme, shtetet kontraktuese duhet, nëse është rasti, t'i drejtohen arbitrazhit, për aq sa rrethanat e lejojnë.



## Neni 39

Konventa mbi arbitrazhin është nënshkruar për çështjet ekzistuese ose për ato që mund të ndodhin në të ardhmen.

Ajo mund të përfshijë çdo mosmarrëveshje ose vetëm mosmarrëveshjet e një kategorie të caktuar.

## Neni 40

Pavarësisht traktateve të përgjithshme ose të fshehta, që përcaktojnë shprehimisht adresimin e arbitrazhit si detyrues për shtetet kontraktuese, shtetet e përmendura i rezervojnë vetes së tyre të drejtën e lidhjes së marrëveshjeve të reja, të përgjithshme ose të veçanta, me qëllim zgjerimin e arbitrazhit të detyrueshme për të gjitha rastet të cilat ata mund t'i konsiderojnë të mundshme për t'u parashtruar.

## KAPITULLI II GJYKATA E PËRHERSHME E ARBITRAZHIT

### Neni 41

Me qëllim që të lehtësohet e drejta për t'iu drejtuar menjëherë arbitrazhit për mosmarrëveshjet ndërkombëtare, të cilat nuk janë arritur të zgjidhen me diplomaci, shtetet kontraktuese marrin përsipër të shfrytëzojnë Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, e themeluar nga Konferenca e Parë e Paqes, së cilës mund t'i drejtohesh në çdo kohë, dhe që vepron në përputhje me rregullat e procedurës të përcaktuara në këtë Konventë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga palët.

### Neni 42

Gjykata e Përhershme është kompetente për të gjitha rastet e arbitrazhit, me përjashtim të rasteve kur palët bien dakord t'i drejtohen një gjykate të posaçme.

### Neni 43

Gjykata e Përhershme e ka selinë në Hagë.

Një zyrë ndërkombëtare shërben si zyrë regjistri për Gjykatën. Ajo është kanali për komunikimet në lidhje me seancat e Gjykatës; ka përgjegjësi për arkivat dhe kryen të gjithë punën administrative.

Shtetet kontraktuese angazhohen t'i transmetojnë zyrës, sa më shpejt të jetë e mundur, një kopje të vërtetuar të çdo marrëveshjeje për arbitrimin të lidhur mes tyre dhe të çdo vendimi gjyqësor të nxjerrë nga një gjykatë e posaçme, që lidhet me to.

Shtetet gjithashtu angazhohen t'i transmetojnë zyrës ligjet, rregulloret dhe dokumentet që tregojnë përfundimisht ekzekutimin e vendimeve të dhëna nga Gjykata.

### Neni 44

Çdo shtet kontraktues zgjedh jo më shumë se katër persona, me njohuri të shquara në çështjet e të drejtës ndërkombëtare, me reputacion të lartë moral dhe të predispozuar për të pranuar detyrat e gjyqtarit të arbitrazhit.

Personat e zgjedhur në këtë mënyrë regjistrohen si anëtarë të Gjykatës në një listë, e cila i njoftohet nga zyra të gjitha shteteve kontraktuese.

Zyra u njofton shteteve kontraktuese çdo ndryshim në listën e gjyqtarëve të arbitrazhit.

Dy ose më shumë shtete mund të bien dakord për zgjedhjen e përbashkët të një ose më shumë anëtarëve.

I njëjti person mund të zgjidhet nga shtete të ndryshme. Anëtarët e Gjykatës caktohen për një periudhë gjashtëvjeçare. Këto emërimet janë të rinovueshme.

Nëse një anëtar i Gjykatës vdes ose jep dorëheqjen, për plotësimin e vendit të lirë ndiqet e njëjta procedurë që ishte ndjekur për emërimin e tij. Në këtë rast emërimi bëhet për një periudhë të re prej gjashtë vjetësh.

#### Neni 45

Kur shtetet kontraktuese dëshirojnë t'i drejtohen Gjykatës së Përhershme për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që ka lindur mes tyre, gjyqtarët e arbitrazhit të thirrur për të formuar gjykatën me juridiksion për të vendosur për këtë mosmarrëveshje duhet të zgjidhen nga lista e përgjithshme e anëtarëve të Gjykatës.

Nëse nuk arrihet marrëveshja e drejtpërdrejtë e palëve në lidhje me përbërjen e Gjykatës së Arbitrazhit, atëherë do të ndiqet rruga e mëposhtme:

Secila palë cakton dy gjyqtarë arbitrazhi, prej të cilëve njëri mund të jetë shtetas i saj ose i zgjedhur nga radhët e personave të zgjedhur prej saj si anëtarë të Gjykatës së Përhershme. Këta gjyqtarë arbitrazhi së bashku zgjedhin një gjyqtar kryesues.

Nëse votat ndahen në mënyrë të barabartë, zgjedhja e gjyqtarit kryesues i caktohet një palë të tretë, e zgjedhur nga palët me marrëveshje të përbashkët.

Nëse nuk arrihet një marrëveshje mbi këtë çështje, secila palë zgjedh një shtet të ndryshëm, dhe zgjedhja e gjyqtarit kryesues bëhet në marrëveshje me shtetet e zgjedhura në këtë mënyrë.

Nëse, brenda dy muajve, këto dy shtete nuk arrijnë një marrëveshje, secila prej tyre paraqet dy kandidatë të marrë nga lista e anëtarëve të Gjykatës së Përhershme, me përjashtim të anëtarëve të zgjedhur nga palët dhe të mos jetë shtetas i tyre. Shorti përcakton se cilët prej kandidatëve të paraqitur në këtë mënyrë do të jetë gjyqtar kryesues.

#### Neni 46

Kur gjykata ka këtë përbërje, palët njoftojnë zyrën për vendosmërinë e tyre për t'iu drejtuar gjykatës, tekstin e "kompromisit" të tyre dhe emrat e gjyqtarëve.

Zyra njofton pa vonesë çdo gjyqtar për "kompromisin" dhe emrat e anëtarëve të tjerë të Gjykatës.

Gjykata takohet në datën e caktuar nga palët. Zyra bën rregullimet e nevojshme për takimin.

Anëtarët e Gjykatës, në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe jashtë vendit të tyre, gëzojnë privilegje dhe imunitete diplomatike.

#### Neni 47

Zyra autorizohet të vendosë zyrat dhe personelin e saj në dispozicion të palëve kontraktuese për përdorim të ndonjë bordi të veçantë arbitrazhi.

Juridiksioni i Gjykatës së Përhershme, në kuadër të kushteve të përcaktuara në rregullore, mund të shtrihet për mosmarrëveshjet mes shteteve jokontraktuese ose mes shteteve kontraktuese dhe jokontraktuese, nëse palët kanë rënë dakord për t'iu drejtuar kësaj Gjykate.

#### Neni 48

Shtetet kontraktuese e konsiderojnë si detyrë të tyre, në rast se një konflikt i rëndë rrezikon të shpërthejë mes dy ose më shumë prej tyre, për të kujtuar këto të fundit se Gjykata e Përhershme është e hapur për ta.

Rrjedhimisht, ata deklarojnë se rikujtesa e palëve në mosmarrëveshje për dispozitat e kësaj Konvente, dhe këshilla që u jepet atyre për t'iu drejtuar Gjykatës së Përhershme, në interesin më të lartë të paqes, mund të konsiderohen vetëm si veprime miqësore.

Në rast konflikti mes dy shteteve, njëri prej tyre mund t'i drejtohet gjithmonë Zyrës Ndërkombëtare me një shkresë që përmban një deklaratë se është i gatshëm të paraqesë konfliktin para Gjykatës.

Zyra duhet të informojë menjëherë palën tjetër për deklaratën.

#### Neni 49

Këshilli i Përhershëm Administrativ, i përbërë nga përfaqësues diplomatikë të shteteve kontraktuese të akredituara në Hagë dhe Ministri i Punëve të Jashtme të Holandës, i cili do të veprojë si kryetar, ngarkohet me drejtimin dhe kontrollin e Zyrës Ndërkombëtare.

Këshilli përcakton rregullat e procedurës dhe të gjitha rregulloret e tjera të nevojshme.

Ai vendos mbi të gjitha çështjet e administrimit, të cilat mund të lindin në lidhje me funksionimin e Gjykatës.

Ai ka kontroll të plotë mbi emërimin, pezullimin ose shkarkimin e zyrtarëve dhe të punësuarve të zyrës.

Ai përcakton pagesat dhe rrogat, dhe kontrollon shpenzimet e përgjithshme.

Në takimet e kryera sipas rregullit, prania e nëntë anëtarëve është e mjaftueshme për t'i bërë të vlefshme diskutimet e Këshillit. Vendimet merren me shumicë votash.

Këshilli i njofton pa vonesë palëve kontraktuese rregulloret e miratuara prej tij. Ai u jep atyre një raport vjetor për punët e Gjykatës, funksionimin e administratës dhe për shpenzimet. Po ashtu, raporti përmban një përmbledhje të asaj që është e rëndësishme në dokumentet që i njoftohen Zyrës nga palët, në bazë të nenit 43, paragrafët 3 dhe 4.

#### Neni 50

Shpenzimet e Zyrës do të përballohen nga palët kontraktuese në masën e caktuar për Zyrën Ndërkombëtare të Bashkimit Postar Universal.

Shpenzimet që do t'u ngarkohen shteteve aderuese, do të llogariten që prej datës që hyn në fuqi aderimi i tyre.

### KAPITULLI III PROCEDURA E ARBITRAZHIT

#### Neni 51

Me synimin për të nxitur zhvillimin e arbitrazhit, palët kontraktuese kanë rënë dakord për rregullat e mëposhtme, të cilat janë të zbatueshme për procedurën e arbitrazhit, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord për rregulla të tjera.

#### Neni 52

Palët, të cilat i drejtohen arbitrazhit nënshkruajnë një "kompromis", në të cilin përcaktohen qartë objekti i mosmarrëveshjes, koha e lejuar për caktimin e gjyqtarëve të arbitrazhit, formulimi, procedura dhe koha në të cilën duhet të bëhet njoftimi i përmendur në nenin 63, dhe vlera e shumës që çdo palë duhet të depozitojë paraprakisht për të mbuluar shpenzimet.

"Kompromisi", gjithashtu, përcakton, nëse ka arsye, mënyrën e emërimit të gjyqtarëve të arbitrazhit, çdo kompetencë të posaçme e cila përfundimisht mund t'i takojë gjykatës, vendin ku do zhvillohet seanca, gjuhën që do të përdoret dhe gjuhët, përdorimi i të cilave do të autorizohet para saj, dhe, në përgjithësi, të gjitha kushtet për të cilat palët kanë rënë dakord.

#### Neni 53

Gjykata e Përhershme është kompetente për zgjidhjen e “kompromisit”, nëse palët kanë rënë dakord t’i drejtohen asaj për këtë qëllim.

Njëkohësisht Gjykata është kompetente edhe nëse kërkesa është bërë vetëm nga njëra palë, kur të gjitha përpyekjet për të arritur një mirëkuptim nëpërmjet kanaleve diplomatike kanë dështuar, si në rastet kur:

1. Një mosmarrëveshje që përfshihet në një traktat të përgjithshëm arbitrazhi, i përfunduar apo i rinovuar, pasi kjo Konventë ka hyrë në fuqi, dhe që parashikon një “kompromis” për të gjitha mosmarrëveshjet, që nuk përjashton zgjidhjen e “kompromisit” nga Gjykata, as në mënyrë të hapur apo të nënkuptuar. Megjithatë, nuk mund të drejtohet çështja në gjykatë nëse pala tjetër deklaron se sipas mendimit të saj konflikti nuk bën pjesë në kategorinë e konflikteve të cilat mund t’i paraqiten arbitrazhit të detyrueshëm, përveç rasteve kur traktati mbi arbitrazhin i jep Gjykatës së Arbitrazhit kompetencë për të vendosur mbi këtë çështje paraprake.

2. Një mosmarrëveshje që lind nga detyrimet kontraktore të pretenduara nga njëri shtet për shtetin tjetër për shkak të shtetasve të tij, dhe që për zgjidhjen e të cilave është pranuar arbitrazhi. Kjo marrëveshje nuk zbatohet, nëse parashikohet kushti që “kompromisi” duhet të zgjidhet në ndonjë mënyrë tjetër.

#### Neni 54

Në rastet e parashikuara në nenin e mësipërm, “kompromisi” do të zgjidhet me një komision të përbërë nga pesë anëtarë të zgjedhur në mënyrën e përcaktuar në nenin 45, paragrafët 3 deri 6.

Anëtari i pestë është kryetari i Komisionit *ex officio*.

#### Neni 55

Funksionet e gjyqtarit të arbitrazhit mund t’i jepen një gjyqtari të vetëm arbitrazhi ose disa gjyqtarëve arbitrazhi të zgjedhur nga palët sipas dëshirës, ose të zgjedhur nga ana e tyre nga anëtarët e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të themeluar nga konventa në fjalë.

Nëse nuk arrihet përbërja e trupit gjykues me marrëveshje të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve, ndiqet mënyra e përcaktuar në nenin 45, paragrafët 3 deri 6.

#### Neni 56

Kur një sovran apo kryetari i një shteti zgjidhet si Gjyqtar Arbitrazhi, procedura e gjykimit vendoset prej tij.

#### Neni 57

Gjyqtari kryesues është kryetari *ex officio* i Gjykatës.

Kur gjykata nuk ka një gjyqtar kryesues, ajo emëron kryetarin e vet.

#### Neni 58

Kur “kompromisi” është vendosur nga një komision, siç parashikohet në nenin 54, dhe në mungesë të një marrëveshjeje për të kundërtën, komisioni vetë do të formojë Gjykatën e Arbitrazhit.

#### Neni 59

Nëse një prej Gjyqtarëve të Arbitrazhit vdes, del në pension ose bëhet i paaftë për çfarëdo arsyeje për kryerjen e funksioneve të tij, për plotësimin e vendit të lirë, ndiqet e njëjta procedurë që ishte ndjekur për emërimin e tij.

#### Neni 60

Gjykata mblidhet në Hagë, përveç rastit kur palët kanë zgjedhur një vend tjetër. Gjykata mund të mblidhet në territorin e një shteti të tretë vetëm me pëlqimin e këtij të fundit.

Pas përcaktimit të vendit të takimit, ai nuk mund të ndryshohet nga gjykata, përveçse me pëlqimin e palëve.

#### Neni 61

Nëse çështja mbi gjuhën që do të përdoret nuk është zgjidhur nga “kompromisi”, kjo do të vendoset nga gjykata.

#### Neni 62

Palët kanë të drejtë të caktojnë agjentë të posaçëm për të marrë pjesë në Gjykatë, për të vepruar si ndërmjetës midis tyre dhe Gjykatës.

Për më tepër, ata autorizohen të emërojnë vetë avokatë ose mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre, për këtë qëllim para gjykatës.

Anëtarët e Gjykatës së Përhershme nuk mund të veprojnë si agjentë, avokatë apo si mbrojtës përveçse në emër të palës që i ka emëruar ata anëtarë të Gjykatës.

#### Neni 63

Si rregull i përgjithshëm, procedura e arbitrazhit përbëhet nga dy faza të dallueshme: faza e deklaratave dhe e diskutimeve verbale.

Deklaratat konsistojnë në komunikimin e agjentëve përkatës me anëtarët e gjykatës dhe palës kundërshtare për rrethanat, kundërrrethanat dhe, nëse është e nevojshme, për përgjigjet; palët përvetësojnë për këtë qëllim të gjitha shkresat dhe dokumentet e kërkuara në këtë rast. Ky komunikim do të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet ndërmjetësimit të Zyrës Ndërkombëtare, në mënyrën dhe kohën e caktuar nga “kompromisi”.

Koha e caktuar nga “kompromisi” mund të zgjatet me marrëveshje nga palët ose nga gjykata, kur kjo e fundit e konsideron të nevojshme me qëllim të arritjes së një vendimi të drejtë.

Diskusimet konsistojnë në debatin verbal të argumenteve të palëve para Gjykatës.

#### Neni 64

Një kopje e vërtetuar e çdo dokumenti të përgatitur nga njëra palë duhet t'i komunikohet palës tjetër.

#### Neni 65

Gjykata nuk mblidhet për diskutim deri në përfundim të deklaratave, me përjashtim të rasteve kur lindin rrethana të veçanta.

#### Neni 66

Diskusimet janë nën drejtimin e kryetarit. Ato janë të hapura vetëm nëse kështu vendoset nga ana e Gjykatës, me pëlqimin e palëve.

Ato regjistrohen në procesverbale të mbajtura nga sekretarët e emëruar nga kryetari. Këto procesverbale nënshkruhen nga kryetari dhe nga një prej sekretarëve dhe vetë kanë karakter autentik.

#### Neni 67

Pas mbylljes së deklaratave, Gjykata ka të drejtë të refuzojë diskutimin e të gjitha shkresave apo dokumenteve të reja, të cilat një nga palët mund të dëshirojë të paraqesë pa pëlqimin e palës tjetër.

#### Neni 68

Gjykata është e lirë të marrë në konsideratë shkresa ose dokumente të reja, për të cilat mund të tërhiqet vëmendja nga agjentët apo avokatët e palëve.

Në këtë rast, Gjykata ka të drejtë të kërkojë paraqitjen e këtyre shkresave ose dokumenteve, por është e detyruar t'i bëjë ato të ditura për palën kundërshtare.

#### Neni 69

Veç kësaj, Gjykata mund të kërkojë nga agjentët e palëve paraqitjen e të gjitha shkresave dhe shpjegimet e nevojshme. Në rast refuzimi, Gjykata mban shënim këtë.

#### Neni 70

Agjentët dhe mbrojtësi i palëve janë të autorizuar për të paraqitur verbalisht në Gjykatë të gjitha argumentet që i konsiderojnë të përshtatshme në mbrojtjen e çështjes së tyre.

#### Neni 71

Ata kanë të drejtë të paraqesin kundërshtime dhe argumente. Vendimet e Gjykatës në këto çështje janë të formës së prerë dhe nuk mund të jenë objekt i ndonjë diskutimi të mëvonshëm.

#### Neni 72

Anëtarët e Gjykatës kanë të drejtë t'i drejtojnë pyetje agjentëve dhe mbrojtësve të palëve, dhe t'u kërkojnë atyre shpjegime mbi çështje të dyshimta.

As pyetjet, as vërejtjet e bëra nga anëtarët e Gjykatës gjatë diskutimeve, nuk mund të konsiderohen si shprehje e mendimit nga Gjykata në përgjithësi ose nga anëtarët e saj në veçanti.

#### Neni 73

Gjykata është e autorizuar të deklarojë kompetencën e saj në interpretimin e “kompromisit”, si dhe të traktateve të tjera, të cilat mund të kërkojnë, dhe në zbatimin e parimeve të së drejtës.

#### Neni 74

Gjykata ka të drejtë të nxjerrë rregullat e procedurës për administrimin e çështjes, për të vendosur mënyrën, formën dhe kohën në të cilën çdo palë duhet të përfundojë argumentet e saj dhe për rregullimin e të gjitha formaliteteve të nevojshme për trajtimin e provave.

#### Neni 75

Palët marrin përsipër t'i japin Gjykatës, sa më shumë të jetë e mundur, të gjithë informacionin e kërkuar për vendimin mbi çështjen.

#### Neni 76

Për të gjitha njoftimet që Gjykata duhet t'i dërgojë në territorin e një pale të tretë kontraktuese, Gjykata do t'i kërkojë drejtpërdrejt qeverisë së atij shteti. I njëjti rregull vlen edhe në rastin e hapave që ndërmerren për të siguruar prova në vend.

Kërkesat për këtë qëllim duhet të ekzekutohen për aq sa e lejon ligji i brendshëm i shtetit të cilit i është bërë kërkesa. Ato nuk mund të refuzohen, me përjashtim të rasteve kur shteti në fjalë i konsideron të qëllimshme për të dëmtuar sovranitetin ose sigurinë e tij.

Gjykata ka gjithmonë të njëjtat të drejta për të vepruar nëpërmjet shtetit, në territorin e të cilit ajo ndodhet.

#### Neni 77

Kur agentët dhe mbrojtësit e palëve kanë paraqitur të gjitha shpjegimet dhe provat në mbrojtje të çështjes së tyre, kryetari shpall mbylljen e diskutimeve.

#### Neni 78

Gjykata shqyrton vendimet e saj në fshehtësi dhe seancat mbeten të fshehta. Të gjitha çështjet vendosen nga një shumicë e anëtarëve të gjykatës.

#### Neni 79

Vendimi duhet të përmbajë arsyet mbi të cilat është bazuar. Ai përmban emrat e gjyqtarëve të arbitrazhit; nënshkruhet nga kryetari dhe kryesekretari ose nga sekretari që kryen detyrën e kryesekretarit.

#### Neni 80

Vendimi lexohet në seancë publike, ku agentët dhe mbrojtësit e palëve janë të pranishëm ose janë thirrur sipas rregullit për të marrë pjesë.

#### Neni 81

Vendimi, i shpallur dhe i njoftuar për agentët e palëve, zgjidh mosmarrëveshjen përfundimisht dhe pa të drejtë apelimi.

#### Neni 82

Çdo mosmarrëveshje që lind mes palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e vendimit, në mungesë të një marrëveshjeje për të kundërtën, do t'i parashtrahet Gjykatës, e cila e ka shpallur atë.

#### Neni 83

Palët mund të rezervojnë në "kompromis" të drejtën për të kërkuar rishikimin e vendimit. Në këtë rast dhe nëse nuk ka një marrëveshjeje për të kundërtën, kërkesa duhet të dërgohet në Gjykatën e cila e ka shpallur vendimin. Ajo mund të bëhet vetëm në bazë të zbulimit të ndonjë fakti të ri i cili ka ndikim thelbësor mbi vendimin dhe që ka qenë i panjohur nga gjykata dhe pala, e cila ka kërkuar rishikimin pas mbylljes së diskutimit.

Procedurat për rishikim mund të fillojnë me një vendim të Gjykatës, i cili shprehimisht paraqet ekzistencën e faktit të ri, duke e dalluar atë sipas natyrës së përshkruar në paragrafin e mësipërm, dhe duke shpallur pranimin e kërkesës mbi këtë bazë.

"Kompromisi" cakton periudhën brenda së cilës duhet të bëhet kërkesa për rishikim.

#### Neni 84

Vendimi nuk është detyrues, përveçse për palët në mosmarrëveshje.

Kur vendimi lidhet me interpretimin e një Konvente, në të cilën shtetet e tjera të ndryshme nga ato në konflikt janë palë, ato do të njoftojnë të gjitha shtetet nënshkruese në kohën e duhur. Secili nga këto shtete ka të drejtë të ndërhyjë në këtë çështje. Nëse një ose më shumë prej tyre përfitojnë nga kjo e drejtë, interpretimi i vendimit është njëloj detyrues dhe për to.

#### Neni 85

Secila palë paguan shpenzimet e saj dhe një pjesë të barabartë të shpenzimeve të Gjykatës.

### KAPITULLI IV ARBITRAZHI ME PROCEDURË TË SHKURTUAR

#### Neni 86

Me qëllim lehtësimin e punës së sistemit të arbitrazhit në konfliktet që pranojnë procedurën e shkurtuar, palët kontraktuese miratojnë rregullat e mëposhtme, të cilat duhet të zbatohen në mungesë të marrëveshjeve të tjera dhe do t'u nënshtrohen rezervave të dispozitave të kapitullit III aq kohë sa mund të zbatohen.

#### Neni 87

Secila nga palët në mosmarrëveshje emëron një gjyqtar arbitrazhi. Të dy gjyqtarët e zgjedhur në këtë mënyrë zgjedhin një gjyqtar kryesues arbitrazhi. Nëse ata nuk bien dakord mbi këtë pikë, secili prej tyre propozon dy kandidatë të marrë nga lista e përgjithshme e anëtarëve të Gjykatës së Përherëshme, përveç anëtarëve të emëruar nga secila prej palëve dhe të shtetasve të tyre; përcaktohet me short se cili nga kandidatët e propozuar në këtë mënyrë do të jetë gjyqtar.

Gjyqtari i zgjedhur kryeson Gjykatën, e cila jep vendime me shumicë votash.

#### Neni 88

Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje të mëparshme, Gjykata, me t'u krijuar, përcakton kohën brenda së cilës të dy palët duhet të paraqesin çështjet e tyre respektive.

#### Neni 89

Secila palë përfaqësohet para Gjykatës nga një agjent, i cili shërben si ndërmjetës ndërmjet Gjykatës dhe Qeverisë që e ka caktuar atë.

#### Neni 90

Shqyrtimi bëhet vetëm me shkrim. Megjithatë, secila palë ka të drejtë të kërkojë thirrjen e dëshmitarëve dhe ekspertëve. Gjykata, nga ana e saj, ka të drejtë të kërkojë shpjegime verbale nga agjentët e të dyja palëve, si dhe nga ekspertët dhe dëshmitarët, paraqitja e të cilëve në Gjykatë mund të konsiderohet e dobishme.

### PJESA V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### Neni 91

Kjo Konventë, e ratifikuar sipas rregullave, do zëvendësojë, mes palëve kontraktuese, Konventën për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare të datës 29 korrik 1899.



## Neni 92

Kjo Konventë do të ratifikohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ratifikimet do të depozitohen në Hagë.

Depozitimi i parë i ratifikimeve do të regjistrohet në një procesverbal të nënshkruar nga përfaqësuesit e shteteve, të cilat marrin pjesë në të dhe nga Ministri i Punëve të Jashtme të Holandës.

Depozitimet e mëvonshme të ratifikimit do të bëhen me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar Qeverisë së Holandës dhe të shoqëruara nga instrumenti i ratifikimit.

Një kopje e vërtetuar e procesverbalit në lidhje me depozitimin e parë të ratifikimit, të njoftimeve të përmendura në paragrafin e mësipërm dhe të instrumenteve të ratifikimit duhet të dërgohet menjëherë nga Qeveria e Holandës, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për shtetet e ftuara në Konferencën e Dytë të Paqes, si për ato shtete, të cilat kanë aderuar në Konventë. Në rastet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, qeveria e lartpërmendur do të informojë në të njëjtën kohë shtetet, për datën në të cilën ka marrë njoftimin.

## Neni 93

Shtetet jonënshkruese, të cilat janë ftuar në Konferencën e Dytë të Paqes, mund të aderojnë në këtë Konventë.

Shteti, i cili dëshiron të aderojë, njofton për këtë qëllim me shkrim Qeverinë e Holandës, duke i dërguar asaj aktin e aderimit, i cili do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së lartpërmendur.

Kjo Qeveri duhet të dërgojë menjëherë për të gjitha shtetet e tjera të ftuara në Konferencën e Dytë të Paqes një kopje të vërtetuar të njoftimit, si dhe të aktit të aderimit, duke përmendur datën në të cilën ka marrë njoftimin.

## Neni 94

Kushtet mbi të cilat shtetet, të cilat nuk janë ftuar në Konferencën e Dytë të Paqes, mund të aderojnë në këtë Konventë, përbëjnë objektin e marrëveshjes pasuese mes palëve kontraktuese.

## Neni 95

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi, në rastin e shteteve që nuk janë palë në depozitimin e parë të ratifikimit, gjashtëdhjetë ditë pas datës së procesverbalit të këtij depozitimi, dhe, në rastin e shteteve të cilat e ratifikojë më vonë, ose që aderojnë, gjashtëdhjetë ditë pasi njoftimi i ratifikimit apo aderimit të tyre të jetë pranuar nga Qeveria e Holandës.

## Neni 96

Në rast kur njëri prej shteteve kontraktuese dëshiron të denoncojë këtë Konventë, denoncimi do t'i njoftohet me shkrim Qeverisë së Holandës, e cila do t'i komunikojë menjëherë një kopje të vërtetuar të njoftimit, të gjitha shteteve të tjera duke informuar ato për datën në të cilën është marrë njoftimi.

Denoncimi do të ketë efekt vetëm në lidhje me shtetin njoftues dhe një vit pasi njoftimi ka mbërritur në Qeverinë e Holandës.

## Neni 97

Një regjistër i mbajtur nga Ministri i Punëve të Jashtme të Holandës, do të japë datën e depozitimit të ratifikimeve të realizuara në bazë të nenit 92, paragrafët 3 dhe 4, si dhe datën në të cilën është marrë njoftimi i aderimit (neni 93, paragrafi 2) apo i denoncimit (neni 96, paragrafi 1).

Çdo shtet kontraktues ka të drejtë të ketë akses në këtë regjistër dhe të marrë ekstrakte të certifikuara prej tij.

Me besim, të plotfuqishmit kanë bashkëngjitur nënshkrimet e tyre në këtë Konventë.  
Bërë në Hagë, më 18 tetor 1907, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Qeverisë së Holandës, dhe kopje të vërtetuara sipas rregullit, do t'u dërgohen shteteve kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

**LIGJ**  
**Nr.10 452, datë 21.7.2011**

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT QË NDRYSHON ANEKSIN E SIGURISË TË  
MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR,  
PËR BASHKËPUNIMIN PËR INFORMACIONIN ATOMIK**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokollin që ndryshon aneksin e sigurisë të marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior, për bashkëpunimin për informacionin atomik, bërë në Bruksel më 2 qershor 1998.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7066, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**PROTOKOLL**  
**QË NDRYSHON ANEKSIN E SIGURISË SË MARRËVESHJES NDËRMJET PALËVE TË  
TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR BASHKËPUNIMIN NË LIDHJE ME  
INFORMACIONIN ATOMIK**

*Duke patur* parasysh që zhvillimet në sigurinë e informacionit atomik kërkojnë rishikimin e shpeshtësisë së inspektimit të plotë të sigurisë së të gjithë elementëve ushtarakë dhe civilë të NATO-s dhe të shteteve anëtare që kanë marrë informacion në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik,  
palët e poshtëshënuara kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Aneksi i sigurisë së marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për Bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, bërë në Paris më 18 qershor 1964, ndryshohet sipas parashikimit në nenin 2.

## Neni 2

Fjalja e parë e seksionit 10, Inspektimet e Sigurisë, paragrafi A, e aneksit të sigurisë së Marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik zëvendësohet me fjalinë e mëposhtme:

“A. Inspektimi i plotë i sigurisë së të gjithë elementëve ushtarakë dhe civilë të NATO-s dhe shteteve anëtare që kanë marrë informacion atomik sipas marrëveshjes kryhet rregullisht, gjatë një periudhe që përcaktohet nga Këshilli i Atlantikut Verior me kriteret e parashikuara në seksionin I, paragrafi A i këtij aneksi.”.

## Neni 3

Ky protokoll hyn në fuqi me marrjen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të njoftimit nga të gjitha shtetet palë në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik, që ata kanë vullnetin t'i nënshtrohen termave të këtij protokollit.

## Neni 4

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon të gjitha palët dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior për çdo njoftim dhe për hyrjen në fuqi të këtij protokollit.

## Neni 5

Ky protokoll mban datën në të cilën është hapur për nënshkrim dhe mbetet i hapur për nënshkrim derisa të nënshkruhet nga të gjitha palët në Marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior për bashkëpunimin në lidhje me informacionin atomik.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e poshtëshënuar kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Bruksel, më 2 qershor 1998, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëllëj autentike, në një kopje origjinale të vetme që depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila u transmeton kopje të certifikuara të saj të gjitha shteteve nënshkruesve dhe aderuese.

## LIGJ

Nr.10 453, datë 21.7.2011

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR DHE PROTOKOLLIT TË SAJ TË ZBATIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

## Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar dhe protokollit të saj të zbatimit”.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7067, datë 29.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

### MARRËVESHJE

#### NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PAAUTORIZUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Serbisë, në emër të shteteve të tyre, më poshtë referuar si “palët kontraktuese”,

*të vendosura* për të forcuar bashkëpunimin e tyre në mënyrë që të luftohet më me efektshmëri emigracioni i paligjshëm;

*me dëshirën* për të krijuar, me anë të kësaj Marrëveshjeje dhe në bazë të reciprocitetit, procedura të shpejta dhe efektive për identifikimin dhe kthimin e sigurt dhe të rregullt të personave të cilët nuk janë në gjendje, ose nuk munden që tani e tutje, të përmbushin kushtet për të hyrë, për praninë, ose qëndrimin e tyre në territoret e palëve kontraktuese, si dhe për të lehtësuar kalimin transit të këtyre personave në një frymë bashkëpunimi;

*duke konfirmuar* gatishmërinë e tyre për të zhvilluar më mirë bashkëpunimin ekzistues dhe për të forcuar partneritetin e tyre në fushën e migracionit;

*duke theksuar* se kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese që rrjedhin nga ligji ndërkombëtar dhe, në veçanti, nga Konventa europiane e 4 nëntorit 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe nga Konventa e 28 korrikut 1951 mbi statusin e refugjatëve;

*duke marrë* parasysh rekomandimin e 30 nëntorit 1994 të Këshillit Europian në lidhje me specimenin e marrëveshjes së ripranimit mes një vendi anëtar dhe një vendi të tretë (Gazeta Zyrtare C 274, 19.9.1996 P.0020-0024),

ranë dakord si vijon:

## Neni 1

### Përkufizime

Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

a) “Palë kontraktuese” do të thotë Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Serbisë;

b) “Shtetas i Republikës së Serbisë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Republikës së Serbisë, në pajtim me legjislacionin e saj;

c) “Shtetas i Republikës së Shqipërisë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e saj;

d) “Qytetar i vendeve të treta” është çdo person që mban një shtetësi tjetër nga ajo e Republikës së Serbisë apo e Republikës së Shqipërisë;

e) “Person pa shtetësi” është çdo person i cili nuk ka një shtetësi të ndonjë vendi;

f) “Leje qëndrimi” do të thotë leje e çdo lloji lëshuar nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese, e cila i jep të drejtë një personi që të banojë në territorin e saj. Kjo nuk do të përfshijë leje të përkohshme për të qëndruar në territorin e saj që lidhet me shqyrtimin e një aplikimi për azil ose një aplikimi për leje qëndrimi;

g) “Vizë” do të thotë një autorizim i dhënë ose një vendim i marrë nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese, i cili është i nevojshëm për hyrje në, ose transitim përmes territorit të saj. Kjo nuk do të përfshijë vizat aeroportuale të transitit;

h) “Shteti kërkues” do të thotë shteti i njëjës nga palët kontraktuese, që dorëzon një aplikim ripranimi sipas nenit 7 ose një aplikim transiti sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje;

i) “Shteti i kërkuar” do të thotë shteti i njëjës nga palët kontraktuese të cilit i është adresuar një aplikim ripranimi sipas nenit 7, ose një aplikim transiti sipas nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje;

j) “Autoriteti kompetent” nënkupton një autoritet kombëtar i palëve kontraktuese, të cilit i është besuar zbatimi i kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 19 (1), germa (a) të kësaj Marrëveshjeje;

k) “Transit” nënkupton kalimin e një qytetari të një vendi të tretë ose një personi pa shtetësi në territorin e shtetit të kërkuar, ndërsa udhëton nga shteti kërkues për në vendin e destinacionit.

## KREU I DETYRIMET E RIPRANIMIT NGA REPUBLIKA E SERBISË

### Neni 2 **Ripranimi i qytetarëve të vet**

1. Republika e Serbisë do të ripranojë, sipas aplikimit, nga Republika e Shqipërisë dhe pa formalitete të tjera të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje, çdo person i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më tej kushtet në fuqi për të hyrë, qëndruar ose banuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që të provohet ose të supozohet vlefshmërisht në bazë të dëshmive *prima facie* të paraqitura, se ky person është shtetas i Republikës së Serbisë.

2. Republika e Serbisë do të ripranojë, gjithashtu, persona të cilëve u është hequr shtetësia e Republikës së Serbisë që prej hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse këtyre personave të paktën nuk u është premtuar natyralizimi nga Republika e Shqipërisë.

3. Pasi Republika e Serbisë i ka dhënë një përgjigje pozitive kërkesës së ripranimit, misioni diplomatik kompetent ose Zyra Konsullore e Republikës së Serbisë duhet menjëherë dhe jo më vonë se tri ditë pune, të lëshojë dokumentin e udhëtimit të nevojshëm për kthimin e personit që do të ripranohet, me afat vlefshmërie prej gjashtë muajsh. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit që ishte lëshuar fillimisht, misioni diplomatik kompetent ose Zyra Konsullore e Republikës së Serbisë, duhet që brenda 14 ditësh kalendarike, të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me një periudhë vlefshmërie me të njëjtën kohëzgjatje. Nëse Republika e Serbisë nuk ka lëshuar brenda 14 ditëve kalendarike dokumentin e ri të udhëtimit, do të konsiderohet se pranon përdorimin e dokumentit të udhëtimit standard të lëshuar nga Republika e Shqipërisë sipas aneksit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Në rast se personi që do të ripranohet, posedon shtetësinë e një shteti të tretë përveç shtetësisë serbe, Republika e Shqipërisë do të marrë në konsideratë vullnetin e personit që do të ripranohet lidhur me shtetin që ai/ajo zgjedh.

### Neni 3 **Ripranimi i qytetarëve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi**

1. Republika e Serbisë do të ripranojë, me kërkesën e Republikës së Shqipërisë dhe pa formalitete të tjera të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje, të gjithë qytetarët e vendeve të treta ose personat pa shtetësi që nuk përmbushin, ose nuk përmbushin më tej kushtet në fuqi për të hyrë, qëndruar ose banuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që të provohet, ose të supozohet vlefshmërisht në bazë të dëshmive *prima facie* të paraqitura se ata persona:

a) mbajnë apo, në kohën e hyrjes, mbanin, një vizë të vlefshme ose leje qëndrimi të lëshuar nga Republika e Serbisë; apo

b) në mënyrë të paligjshme dhe drejtpërdrejt hynë në territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi kanë qëndruar apo kaluar nëpër territorin e Republikës së Serbisë.

2. Detyrimi për ripranim në paragrafin 1 nuk zbatohet nëse:

a) një qytetar i vendit të tretë ose person pa shtetësi, ka qenë vetëm në zonën ajrore transit të një aeroporti ndërkombëtar të Republikës së Serbisë; ose

b) Republika e Shqipërisë i ka lëshuar një qytetari të një vendi të tretë ose personi pa shtetësi, një vizë ose leje qëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e saj në qoftë se:

- personi zotëron një vizë ose leje qëndrimi, të lëshuar nga Republika e Serbisë, e cila skadon më vonë; ose

- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Republika e Shqipërisë është marrë duke përdorur dokumente të falsifikuara ose fals, ose duke bërë deklaratatë të pavërteta, dhe kur personi në fjalë ka qëndruar, ka kaluar transit në territorin e Republikës së Serbisë; ose

- kur personi nuk arrin të respektojë ndonjë nga kushtet që lidhen me vizat dhe se personi ka qëndruar apo ka transituar në territorin e Republikës së Serbisë.

3. Pasi Republika e Serbisë i ka dhënë një përgjigje pozitive kërkesës për ripranim, Republika e Shqipërisë i lëshon personit të cilit i është pranuar ripranimi dokumentin e udhëtimit të kërkuar për kthimin e tij apo të saj në Republikën e Serbisë.

## KREU II

### DETYRIMET E RIPRANIMIT NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

#### Neni 4

#### **Ripranimi i qytetarëve të vet**

1. Republika e Shqipërisë do të ripranojë, sipas aplikimit nga Republika e Serbisë dhe pa formalitete të tjera të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje, çdo person i cili nuk përmbush, ose nuk përmbush më tej kushtet në fuqi për të hyrë, qëndruar ose banuar në territorin e Republikës së Serbisë, me kusht që të provohet, ose të supozohet vlefshmërisht në bazë të dëshmive *prima facie* të paraqitura, se ky person është shtetas i Republikës së Shqipërisë.

2. Republika e Shqipërisë do të ripranojë, gjithashtu, persona të cilëve u është hequr shtetësia e Republikës së Shqipërisë që prej hyrjes në territorin e Republikës së Serbisë, nëse këtyre personave të paktën nuk u është premtuar natyralizimi nga Republika e Serbisë.

3. Pasi Republika e Shqipërisë i ka dhënë një përgjigje pozitive kërkesës së ripranimit, misioni diplomatik kompetent ose Zyra Konsullore e Republikës së Shqipërisë duhet menjëherë dhe jo më vonë se tri ditë pune, të lëshojë dokumentin e udhëtimit të nevojshëm për kthimin e personit që do të ripranohet, me afat vlefshmërie prej gjashtë muajsh. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit që ishte lëshuar fillimisht, misioni diplomatik kompetent ose Zyra Konsullore e Republikës së Shqipërisë, duhet që brenda 14 ditësh kalendarike, të lëshojë një dokument të ri udhëtimi me një periudhë vlefshmërie me të njëjtën kohëzgjatje. Nëse Republika e Shqipërisë nuk ka lëshuar brenda 14 ditëve kalendarike dokumentin e ri të udhëtimit, do të konsiderohet se pranon përdorimin e dokumentit të udhëtimit standard të lëshuar nga Republika e Serbisë sipas aneksit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Në rast se personi që do të ripranohet posedon shtetësinë e një shteti të tretë përveç shtetësisë së Republikës së Shqipërisë, Republika e Serbisë do të marrë në konsideratë vullnetin e personit që do të ripranohet lidhur me shtetin që ai/ajo zgjedh.

#### Neni 5

#### **Ripranimi i qytetarëve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi**

1. Republika e Shqipërisë do të ripranojë, me kërkesën e Republikës së Serbisë dhe pa formalitete të tjera të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë Marrëveshje, të gjithë qytetarët e

vendeve të treta ose personat pa shtetësi që nuk përmbushin, ose nuk përmbushin më tej kushtet në fuqi për të hyrë, qëndruar ose banuar në territorin e Republikës së Serbisë, me kusht që të provohet, ose të supozohet vlefshmërisht në bazë të dëshmive *prima facie* të paraqitura se ata persona:

a) mbajnë, apo në kohën e hyrjes mbanin, një vizë të vlefshme ose leje qëndrimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë; apo

b) në mënyrë të paligjshme dhe drejtpërdrejt hyjnë në territorin e Republikës së Serbisë pasi kanë qëndruar, apo kaluar transit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Detyrimi për ripranim në paragrafin 1 nuk zbatohet nëse:

a) një qytetar i vendit të tretë ose person pa shtetësi, ka qenë vetëm në zonën ajrore transit të një aeroporti ndërkombëtar të Republikës së Shqipërisë; ose

b) Republika e Serbisë i ka lëshuar një qytetari të një vendi të tretë ose personi pa shtetësi, një vizë ose leje qëndrimi para ose pas hyrjes në territorin e saj në qoftë se:

- personi zotëron një vizë ose leje qëndrimi, të lëshuar nga Republika e Shqipërisë, e cila skadon më vonë; ose

- viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga Republika e Serbisë është marrë duke përdorur dokumente të falsifikuara ose fals, ose duke bërë deklaratata të pavërteta, dhe kur personi në fjalë ka qëndruar, ka kaluar transit, në territorin e Republikës së Shqipërisë; ose

- kur personi nuk arrin të respektojë ndonjë nga kushtet që lidhen me vizat dhe se personi ka qëndruar, apo ka tranzituar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Pasi Republika e Shqipërisë i ka dhënë një përgjigje pozitive kërkesës për ripranim, Republika e Serbisë i lëshon personit të cilit i është pranuar ripranimi dokumentin e udhëtimit të kërkuar për kthimin e tij apo të saj në Republikën e Serbisë.

### KREU III PROCEDURA E RIPRANIMIT

#### Neni 6 **Parimet**

1. Çdo transferim i një personi që do të ripranohet në bazë të njërit nga detyrimet e përcaktuara në nenet 2-5 të kësaj Marrëveshjeje, do të kërkojë dorëzimin e një kërkesë ripranimi bërë autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar, përveç rastit të përshkruar në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Nuk do të jetë e nevojshme një kërkesë ripranimi, kur personi që të ripranohet është në zotërim të një dokumenti udhëtimi të vlefshëm dhe në rast se një person që është një qytetar i një vendi të tretë ose person pa shtetësi ka, gjithashtu, një vizë të vlefshme ose leje qëndrimi në shtetin e kërkuar. Pala kërkuese do të informojë me shkrim palën e kërkuar mbi ripranimin e qytetarit në territorin e saj.

3. Nëse një person është kapur në zonën kufitare (duke përfshirë aeroportet) të shtetit kërkuar pasi ka kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme duke ardhur direkt nga territori i shtetit të kërkuar, shteti kërkuar mund të dorëzojë një aplikim ripranimi brenda 2 ditësh pune pas kapjes së tij (procedura e përshpejtuar).

#### Neni 7 **Aplikimi për ripranim**

1. Për aq sa të jetë e mundur, aplikimi i ripranimit duhet që të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) të dhënat e personit që do të ripranohet (p.sh.: emrat, mbiemrat, data dhe vendi i lindjes, dhe vendin e fundit të banimit ose informacione të tjera me interes për procesin e ripranimit) dhe, kur është e mundur, të dhënat e fëmijëve të mitur, të pamartuar dhe/ose bashkëshortët;

b) dokumentet, në bazë të të cilave provohet shtetësia dhe të tregohen mjetet me të cilat dëshmohet shtetësia në mënyrë *prima facie*, transiti, kushtet për ripranimin e qytetarëve nga një vend i tretë dhe personat pa shtetësi dhe të paraqiten dokumente lidhur me hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm;

c) foto e personit që do të ripranohet.

2. Një formular i përbashkët që do të përdoret për aplikimet e ripranimit është bashkëngjitur si aneksi 2 i kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 8

##### **Mënyrat e vërtetimit të shtetësisë**

1. Vërtetimi i shtetësisë sipas nenit 2 (1) dhe nenit 4 (1) mund të bëhet i mundur veçanërisht përmes dokumenteve të listuara në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e vlefshmërisë e tyre ka skaduar. Nëse janë paraqitur dokumente të tilla, palët kontraktuese do të njohin reciprokisht shtetësinë pa kërkuar hetim të mëtejshëm. Prova e shtetësisë nuk mund të bëhet me dokumente të rreme.

2. Dëshmitë e shtetësisë *prima facie*, sipas nenit 2 (1) dhe nenit 4 (1) të kësaj Marrëveshjeje mund të ofrohen veçanërisht përmes dokumenteve të paraqitura në aneksin 4 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse periudha e vlefshmërisë së tyre ka skaduar. Nëse janë paraqitur dokumente të tilla, palët kontraktuese do të pranojnë shtetësinë, nëse nuk mund të provojnë të kundërtën. Vërtetimi *prima facie* i shtetësisë nuk mund bëhet me dokumente të rreme.

3. Nëse asnjë nga dokumentet e paraqitura në anekset 3 dhe 4 të Marrëveshjes nuk mund të paraqitet, përfaqësitë diplomatike dhe konsullore kompetente të shtetit të kërkuar ose çdo autoritet tjetër brenda strukturës ligjore të shtetit të kërkuar, sipas kërkesës, mund të intervistojë personin që do të ripranohet pa vonesë, më së shumti brenda tri ditë pune nga data e kërkesës, në mënyrë që të ndihmojë në përcaktimin e shtetësisë së tij ose të saj.

#### Neni 9

##### **Mënyrat e vërtetimit të shtetësisë së qytetarëve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi**

1. Vërtetimi i shtetësisë për ripranimin e qytetarëve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi sipas nenit 3 (1) dhe nenit 5 (1) të kësaj Marrëveshjeje mund të bëhet i mundur veçanërisht përmes provave të paraqitura në aneksin 5 të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk mund të bëhet me dokumente të rreme. Prova të tilla do të njihen reciprokisht nga palët kontraktuese pa kërkuar hetim të mëtejshëm.

2. Dëshmitë e shtetësisë *prima facie*, për ripranimin e qytetarëve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi sipas nenit 3 (1) dhe nenit 5(1) të kësaj Marrëveshjeje mund të ofrohen veçanërisht përmes dokumenteve të paraqitura në aneksin 6 të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk mund të bëhen me dokumente të rreme. Kur paraqiten këto prova *prima facie*, palët kontraktuese do të pranojnë kushtet për t'u caktuar, nëse nuk mund të provojnë të kundërtën.

3. Hyrja e paligjshme, prania ose qëndrimi do të përcaktohet me anë të dokumenteve të udhëtimit të personit në fjalë në të cilën vizat e nevojshme apo lejet e qëndrimit për territorin e shtetit kërkues nuk gjenden. Një deklaratë nga ana e shtetit kërkues që personi në fjalë është gjetur pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit, pa vizë ose leje qëndrimi, gjithashtu, konsiderohet si dëshmi *prima facie* e hyrjes së paligjshme, qëndrimit ose banimit.

#### Neni 10

##### **Afatet kohore**

1. Kërkesa e ripranimit duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda një maksimumi prej një viti pasi autoriteti kompetent i shtetit kërkues ka marrë dijeni se një qytetar i një vendi të tretë apo një person pa shtetësi nuk është në gjendje, ose nuk mundet që tani e tutje, të



përmbushë kushtet në fuqi për hyrje, banim ose qëndrim. Kur ka pengesa ligjore ose faktike që aplikimi të dorëzohet në kohë, afati kohor, me kërkesë nga ana e shtetit kërkues, mund të zgjatet, por vetëm deri atëherë kur pengesat të kenë pushuar së ekzistuari.

2. Çdo kërkesë ripranimi i duhet përgjigjur me shkrim brenda 15 ditëve kalendarike. Ky afat fillon të matet që nga data e marrjes së kërkesës së ripranimit.

3. Kur ka pengesa ligjore ose faktike që kërkesës t'i jepet përgjigje brenda 15 ditëve kalendarike, ky afat kohor, me kërkesë të motivuar siç duhet, mund të zgjatet deri në një maksimum prej gjashtë ditëve kalendarike.

4. Duhet të jepen arsyet për refuzimin e aplikimit për ripranim.

5. Pas pranimit të kërkesës, personi në fjalë duhet të transferohet brenda gjashtë muajve. Me kërkesë të shtetit kërkues, ky afat mund të zgjatet duke shtuar kohën e harxhuar për tejkalimin e pengesave ligjore apo praktike.

#### Neni 11

### Mënyrat e transferimit dhe mjetet e transportit

1. Përpara se të kthejnë një person, autoritetet kompetente të palëve kontraktuese do të bien dakord paraprakisht me shkrim lidhur me datën e kthimit, pikën e kalimit kufitar, shoqërimin e mundshëm dhe mbi informacione të tjera me rëndësi për kthimin.

2. Për aq sa të jetë e mundur dhe nëse është e nevojshme, marrëveshjet me shkrim të përmendura te paragrafi 1 i këtij neni duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) një deklaratë që tregon se personi që do të transferohet mund të ketë nevojë për ndihmë ose kujdes, nëse kjo është në interesin e personit në fjalë;

b) ndonjë mbrojtje tjetër apo masë sigurie, të cilat mund të jenë të nevojshme në rast transferimi individual ose informacion në lidhje me shëndetin e personit, nëse është në interes të personit në fjalë.

3. Transporti mund të bëhet nga ajri apo nga toka. Kthimi nga ajri nuk do të kufizohet në përdorimin e shoqërive ajrore kombëtare të palëve kontraktuese dhe mund të bëhet duke përdorur fluturime të planifikuara ose charter. Në rast të kthimeve të shoqëruara, personeli i shoqërimit duhet të sigurohet nga shteti kërkues.

#### Neni 12

### Ripranimi i gabuar

Shteti kërkues do të marrë mbrapsht çdo person që ripranohet nga ana e shtetit të kërkuar nëse është vërejtur, brenda një periudhe prej tri muajsh pas kthimit të personit në fjalë, që kërkesat e përcaktuara në nenet 2 deri 5 të kësaj Marrëveshjeje nuk janë përmbushur. Në këto raste, dispozitat procedurale të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen *mutatis mutandis* dhe do të ofrohet i gjithë informacioni në dispozicion në lidhje me identitetin e vërtetë dhe shtetësinë e personit që do të kthehet mbrapsht.

#### KREU IV TRANSITI

#### Neni 13

### Parimet

1. Palët kontraktuese duhet të kufizojnë kalimin transit të shtetasve nga vendet e treta ose të personave pa shtetësi në rastet kur personat e tillë nuk mund të kthehen në rrugë të drejtpërdrejtë në shtetin e destinacionit.

2. Palët kontraktuese do të lejojnë kalimin tranzit, të shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi nëse kërkohet, nëse udhëtimi i mëtejshëm drejt shteteve të tjera të mundshme transit ose të ripranimit është i siguruar nga shteti i destinacionit.

3. Transiti mund të refuzohet:

a) në qoftë se qytetari nga një vend i tretë ose personi pa shtetësi ndeshet me një rrezik real për t'iu nënshtruar torturës ose trajtimit çnjerëzor ose degradues apo ndëshkimit ose dënimit me vdekje apo të persekutimit për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar social ose politik në shtetin e destinacionit ose në një shtet tjetër transit; ose

b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi, do t'u nënshtrohet sanksioneve penale në shtetin e kërkuar ose në një shtet tjetër të transitit; ose

c) në të mirë të shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik ose interesave kombëtarë të tjerë të shtetit të kërkuar.

4. Secila palë kontraktuese mund të revokojë çdo autorizim të lëshuar në qoftë se rrethanat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni lindin ose dalin në dritë më vonë gjatë operacionit të transitit, ose nëse udhëtimi i mëtejshëm për në shtetet e mundshme të transitit ose të ripranimit nga shteti i destinacionit nuk është më i sigurt. Në këtë rast, shteti kërkuar do të marrë mbrapsht shtetasin e vendit të tretë ose personin pa shtetësi, siç është e nevojshme dhe pa vonesë.

#### Neni 14

### **Procedurat e transitit**

1. Një kërkesë me shkrim, për operacionet e transitit duhet të paraqitet tek autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) llojin e transitit (nga ajri apo toka), shtetet e tjera të mundshme të transitit dhe të destinacionit përfundimtar të synuar;

b) të dhënat personale të personit në fjalë (p.sh.: emrin, mbiemrin, mbiemrin e vajzërisë, emra të tjerë të përdorur/me të cilat njihet apo pseudonime, data e lindjes, seksi dhe/ose çdo informacion tjetër me interes për procesin e ripranimit, po të jetë e mundur: vendi i lindjes, shtetësia, gjuha, llojin dhe numri i dokumentit të udhëtimit);

c) pikën e kalimit kufitar të parashikuar, kohën e transferimit dhe përdorimin e mundshëm të eskortës;

d) një deklaratë nga ana e shtetit kërkuar, që dëshmon se ai konsideron se kushtet e përshkruara në nenin 13 (2), të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur dhe se nuk ka njohuri për ekzistencën e arsyeve për refuzimin e aplikimit në bazë të nenit 13 (3), të kësaj Marrëveshjeje.

2. Një formular i përbashkët që do të përdoret për aplikimet e transitit është bashkëngjitur si aneksi 7 i kësaj Marrëveshjeje.

3. Shteti i kërkuar do të informojë, brenda tri ditë pune dhe me shkrim, shtetin kërkuar mbi transitin, duke konfirmuar pikën e hyrjes dhe kohën e parashikuar të transitit, ose ta informojë atë për refuzimin e transitit dhe arsyet për një refuzim të tillë.

4. Nëse operacioni i transitit do të bëhet nga ajri, personi që do të transferohet dhe eskorta e mundshme do të përjashtohen nga detyrimi për të marrë një vizë transit në aeroport.

5. Autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar, varësisht nga konsultimet e përbashkëta, ndihmojnë në operacionet e transitit, në veçanti përmes mbikëqyrjes së personave në fjalë dhe ofrimin e lehtësirave të përshtatshme për këtë qëllim.

#### KREU V

### **KOSTOT**

#### Neni 15

### **Kostot e transportit dhe transitit**

1. Pa cenuar të drejtën e autoriteteve kompetente për të rimbursuar shpenzimet lidhur me ripranimin e personit që do të ripranohet ose nga palët e treta, të gjitha shpenzimet e transportit të bëra në lidhje me ripranimin dhe operacionet e transitit në përputhje me këtë Marrëveshje, deri në hyrjen në kufirin e shtetit të destinacionit përfundimtar do të mbulohen nga shteti kërkuar.

2. Kostot e mundshme shtesë që dalin nga kthimi në një shtet të tretë siç përmendet në nenin 2 (5) dhe nenin 4 (5) të kësaj Marrëveshjeje do të përballohen nga personi që do të ripranohet.

## KREU VI MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KLAUZOLA E MOSNDIKIMIT

### Neni 16

#### **Mbrojtja e të dhënave**

Komunikimi i të dhënave personale duhet të bëhet vetëm nëse një komunikim i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese. Përpunimi dhe trajtimi i të dhënave personale në një rast të veçantë do t'u nënshtrohet ligjeve të brendshme të palëve kontraktuese. Përveç kësaj, do të zbatohen parimet e mëposhtme:

- a) të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- b) të dhënat personale duhet të mblidhen për qëllimin e specifikuar, të qartë dhe të duhur të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk përpunohen më tutje nga autoriteti komunikues, as nga autoriteti marrës në një mënyrë të papajtueshme me këtë qëllim;
- c) të dhënat personale duhet të jenë të sakta, të rëndësishme dhe jo të tepërta në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe/ose përpunuar, në veçanti, të dhënat personale të komunikuar mund të lidhen vetëm me:
  - të dhënat personale të personit që do të ripranohet ose transitohet (p.sh.: emrat, mbiemrat, ndonjë emër të mëparshëm, emrat e të tjerë të përdorur me të cilat njihet apo pseudonime, seksi, gjendja civile, data dhe vendi i lindjes, shtetësia aktuale dhe çdo shtetësi e mëparshme, si dhe çdo informacion tjetër me interes për procesin e ripranimit ose transitit);
  - pasaporta, karta e identitetit ose leja e drejtimit të automjetit (numri, periudha e vlefshmërisë, data e lëshimit, organi lëshues, vendi i lëshimit);
  - vendqëndrimet dhe itineraret e udhëtimit;
  - të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të ripranohet ose transitohet ose për të shqyrtuar kërkesat e ripranimit në pajtim me këtë Marrëveshje;
- d) të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësohen;
- e) të dhënat personale duhet të mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave, por jo më shumë se ç'është e domosdoshme për qëllimin për të cilin të dhënat janë mbledhur ose për të cilat ato përpunohen më tutje;
- f) Si autoriteti komunikues, ashtu dhe autoriteti marrës do të ndër marrin çdo hap të arsyeshëm për të siguruar siç duhet që të mos ndodhë korrigjimi, fshirja ose bllokimi i të dhënave personale, kur përpunimi nuk është në pajtim me dispozitat e këtij neni, në veçanti për shkak se këto të dhëna nuk janë të duhura, të rëndësishme, të sakta, ose ato janë të tepërta në lidhje me qëllimin e përpunimit të tyre. Kjo përfshin edhe njoftimin e ndonjë korrigjimi, fshirje ose bllokimin e palës tjetër kontraktuese;
- g) sipas kërkesës, autoriteti kompetent marrës do të informojë autoritetin kompetent komunikues mbi përdorimin e të dhënave të komunikuar dhe rezultatet e marra prej tyre;
- h) të dhënat personale mund t'u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente. Komunikimi i mëtejshëm organeve të tjera kërkon pëlqimin paraprak të autoritetit komunikues;
- i) autoritetet komunikuese dhe marrëse kanë detyrimin për të mbajtur dosje me shkrim për komunikimin dhe marrjen e të dhënave personale.

### Neni 17

#### **Klauzola e mosndikimit**

Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese që rrjedhin nga ligji ndërkombëtar dhe, në veçanti, nga:

- Konventa e 28 korrikut 1951 mbi statusin e refugjatëve të ndryshuar me protokollin e 31 janarit 1967 mbi statusin e refugjatëve;

- Konventat ndërkombëtare për përcaktimin e shtetit përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për azil;
- Konventa Europiane e 4 nëntorit 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Konventa e 10 dhjetorit 1984 kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ose dënimit;
- konventat ndërkombëtare mbi ekstradimin;
- konventat ndërkombëtare shumëpalëshe dhe marrëveshjeve për ripranimin e shtetasve të huaj.

## KREU VII ZBATIMI DHE APLIKIMI

### Neni 18 **Takimet e ekspertëve**

Me kërkesë të njëres prej palëve kontraktuese, palët kontraktuese do të organizojnë takime të ekspertëve mbi zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 19 **Protokolli i zbatimit**

1. Palët kontraktuese do të lidhin një protokoll zbatimi, i cili do të përcaktojë rregullat mbi:
  - a) caktimin e autoriteteve kompetente, pikat e kalimit kufitar dhe shkëmbimin e pikave të kontaktit;
  - b) kushtet për kthimet e shoqëruara, duke përfshirë edhe kalimin tranzit të shtetasve të vendeve të treta dhe atyre pa shtetësi me shoqërim.
2. Protokolli i zbatimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të hyjë në fuqi në të njëjtën ditë me Marrëveshjen.

## KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 20 **Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi**

1. Kjo Marrëveshje do të ratifikohet ose miratohet nga palët kontraktuese në përputhje me procedurat e tyre përkatëse.
2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me anë të të cilit palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e brendshme ligjore që janë të nevojshme për hyrjen në fuqi janë përfunduar.
3. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pakufizuar.
4. Secila palë kontraktuese mundet që, duke njoftuar zyrtarisht palën tjetër kontraktuese, të pezullojë përkohësisht, në mënyrë të plotë ose pjesërisht, zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me qytetarët e vendeve të treta dhe personat pa shtetësi, për arsyet e sigurisë, ruajtjes së rendit publik ose shëndetit publik. Pezullimi hyn në fuqi në ditën e dytë që pason këtë njoftim.
5. Çdo palë kontraktuese mund të propozojë amendime për këtë Marrëveshje, të cilat nëse pranohen nga pala tjetër kontraktuese, do të hyjnë në fuqi me të njëjtën procedurë si vetë Marrëveshja.
6. Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë këtë Marrëveshje, duke njoftuar zyrtarisht palën tjetër kontraktuese. Kjo Marrëveshje do të pushojë së aplikuari gjashtë muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.

Nënshkruar në Durrës, më 23.4.2011 në dy kopje, secila në shqip, serbisht dhe anglisht, duke qenë të gjitha tekstat njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjes në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të përdoret versioni në gjuhën angleze.

ANEKSI 1  
Emri i shtetit

DOKUMENT UDHËTIMI  
Për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar  
(Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, nënshkruar më..... në.....)

Prot.  
Nr.

I vlefshëm për 1 udhëtim nga:

Vendi i nisjes:

Destinacioni:

Emri

Mbiemri:

Fotoja dhe vula

Data e lindjes:

Gjatësia:

Shenja dalluese:

Shtetësia:

Adresa në vendlindje (nëse dihet):

Autoriteti lëshues:

Lëshuar më:

Lëshuar në:

Nënshkrimi:

Autoriteti

Shënime: \_\_\_\_\_

## ANEKSI 2



Autoriteti kërkues

Vendi dhe data

Prot.

.....

Drejtuar: .....

.....

.....

(autoriteti marrës)

### APLIKIM RIPRANIMI

Sipas nenit 7 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar

A. Detajet personale

B. Emri i plotë (të nënvizohet mbiemri)

Foto

.....

1. Emri i vajzërisë:.....

2. Data dhe vendi i lindjes: .....

3. Emri i babait dhe i nënës:

4. Seksi dhe përshkrimi fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenja dalluese etj.):

5. Gjithashtu, i njohur si (emra të mëparshëm, emra të tjerë të përdorur/me të cilët njihet ose pseudonime):

6. Shtetësia dhe gjuha:

7. Gjendja civile: i/e martuar beqar/e divorcuar i/e ve martuar: emri i bashkëshortit/es

.....

.....

8. Emri dhe mosha e fëmijëve (nëse ka)

.....

.....

.....

.....

9. Adresa e fundit në shtetin kërkues:

.....

.....

.....

B. Rrethana të veçanta që lidhen me transferimin

1. Gjendja shëndetësore  
(p.sh. referenca të mundshme për kujdes të veçantë mjekësor; emri latin i sëmundjes ngjitëse):  
.....

2. Indikacion për person veçanërisht të rrezikshëm  
(p.sh. i dyshuar për krime të rënda; sjellje agresive):  
.....

C. Mjetet e provës bashkëlidhur

1.....  
(lloji i dokumentit) (numri serial, data dhe vendi i lëshimit)

.....  
(autoriteti lëshues) (data e skadimit)

2.....  
(lloji i dokumentit) (numri serial, data dhe vendi i lëshimit)

.....  
(autoriteti lëshues) (data e skadimit)

3.....  
(lloji i dokumentit) (numri serial, data dhe vendi i lëshimit)

.....  
(autoriteti lëshues) (data e skadimit)

4.....  
(lloji i dokumentit) (numri serial, data dhe vendi i lëshimit)

.....  
(autoriteti lëshues) (data e skadimit)

D. Vërejtje

.....

.....

.....

..... (nënshkrimi i autoritetit lëshues) (vula)

ANEKSI 3

LISTA E DOKUMENTEVE, PREZANTIMI I TË CILAVE KONSIDEROHET SI PROVË E SHTETËSISË: (NENET 2 (1), 4 (1))

1. Për Republikën e Serbisë:

- pasaportë biometrike,
- kartë identiteti biometrike.

2. Për Republikën e Shqipërisë

- pasaporta të çdo lloji (pasaporta kombëtare, pasaporta diplomatike, pasaporta shërbimi, pasaporta kolektive, si dhe pasaporta zëvendësuese, duke përfshirë pasaportat e fëmijëve):
  - kartë identiteti biometrike;
  - kartë marinari;
  - certifikatë shtetërore, si dhe dokumente të tjera zyrtare që përmendin ose tregojnë shtetësinë.

#### ANEKSI 4

##### LISTË E DOKUMENTEVE TË PËRBASHKËTA PREZANTIMI I TË CILAVE KONSIDEROHET SI PROVË *PRIMA FACIE* PËR SHTETËSINË (NENET 2 (1), 4 (1))

- Fotokopje të cilitdo prej dokumenteve të listuara në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje;
- Leje drejtimi automjeti ose fotokopje të tyre;
- Certifikata lindje ose fotokopje të tyre;
- Karta identiteti të kompanive ose fotokopje të tyre;
- Deklarata nga dëshmitarë;
- Deklaratë e bërë nga personi në fjalë dhe gjuha e folur prej tij/saj, duke përfshirë një rezultat testi zyrtar;
- Çdo dokument tjetër që mund të ndihmojë në përcaktimin e shtetësisë të personit në fjalë.

#### ANEKSI 5

##### LISTË E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE QË KONSIDEROHEN SI PROVË PËR KUSHTET E RIPRANIMEVE TË QYTETARËVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI (NENI 3 (1), NENI 5 (1) DHE NENI 9(1))

- Vulat e hyrjeve/daljeve ose miratime të përafërta në dokumentin e udhëtimit të personit në fjalë ose prova të tjera të hyrjes/daljes (p.sh. fotografike);
- Dokumente, certifikata dhe fatura të çdo lloji (p.sh.: fatura hoteli, takime për trajtim mjekësor ose spitalor, karta hyrjeje për institucione publike/private, dokument qiramarrje makine, fatura kartash krediti etj.) të cilat tregojnë qartësisht që personi në fjalë ka qëndruar në territorin e shtetit të kërkuar;
- Bileta dhe/ose lista pasagjerësh të udhëtimit me avion, me tren, anije udhëtarësh që tregojnë prezencën dhe itinerarin e personit në fjalë në territorin e shtetit të kërkuar;
- Deklarata zyrtare të bëra, në veçanti nga stafi i autoritetit kufitar hyrës dhe nga dëshmitarë të tjerë që mund të dëshmojnë për kalimin e kufirit të personit në fjalë;
- Deklaratë zyrtare nga personi në fjalë në procedura ligjore ose administrative.

#### ANEKSI 6

##### LISTË E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE QË KONSIDEROHEN SI PROVË *PRIMA FACIE* TË KUSHTEVE PËR RIPRANIM TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI (NENI 3 (1), NENI 5 (1) DHE NENI 9 (2))

- Përshkrim i vendit dhe rrethanave nën të cilat personi në fjalë është kapur pasi ka hyrë në territorin e shtetit kërkuar, e lëshuar nga autoritete të rëndësishme të këtij shteti;
- Informacion që lidhet me identitetin dhe/ose qëndrimin e personit që është lëshuar nga një organizatë ndërkombëtare;
- Raporte/konfirmime të informacionit nga pjesëtarë të familjes, shoqëruar të udhëtimit etj.;
- Informacion që tregon se personi në fjalë ka përdorur shërbimet e një agjencie udhëtimi ose agjencie postare;
- Deklaratë nga personi në fjalë.



## ANEKSI 7

Emblema e shteteve

.....  
..... (vendi dhe ora) (autoriteti kërkues)

Prot: .....

Drejtuar

.....

.....  
(Autoriteti marrës)

### APLIKIMI TRANSIT

Sipas nenit 14 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar

#### A. Detaje personale

1. Emri i plotë (të nënvizohet mbiemri):

Foto.....

2. Emri i vajzërisë: .....

3. Data dhe vendi i lindjes: .....

4. Seksi dhe përshkrim fizik (gjatësia, ngjyra e syve, shenja dalluese etj.): .....

5. Gjithashtu i njohur si (emra të mëparshëm, nofka ose pseudonime): .....

6. Shtetësia dhe gjuha: .....

7. Lloji dhe numri i dokumentit të udhëtimit: .....

#### B. Operacioni transit

1. Lloji i transitit □ajror □detar □tokësor

2. Shteti i destinacionit final .....

3. Shtete të tjera të mundshme të transitit .....

4. Pikat e kalimit kufitar të propozuara, data, koha e transferimit dhe shoqërimi i mundshëm

.....  
.....  
.....

5. Pranimi i garantuar në një tjetër shtet transit dhe në shtetin e destinacionit final (neni 13 paragrafi 2)

po      jo

6. Djeni mbi ndonjë arsye të refuzimit të transitit (neni 13 paragrafi 3)

po      jo

#### C. Vërejtje

.....  
.....  
.....

.....  
.....  
.....

..... (nënshkrimi i autoritetit lëshues) (vula)

**VENDIM**  
**Nr.527, datë 20.7.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.

3. Paga bazë minimale orare të jetë 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.

4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.

5. Vendimi nr.566, datë 14.7.2010 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e paës minimale në shkallë vendi”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2011.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 5.8.2011  
Doli nga shtypi më 7.8.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë